



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3609 /2021
Data: 19.05.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katërt -IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.04.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emërgjencë), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të Kompanisë Pastrimi), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se një anëtarë i kuvendit të komunës është i sëmurë prej koronavirusit dhe është i lidhur me zoom, ndërsa anëtarët e tjerë të gjithë janë prezentë.

RENDI I PUNËS

1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Habib Thaçi.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përvèç pikave të rendit të punës që i kemi përcjell kemi edhe një material shtesë propozim vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01.Nr.2010/2021 për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.

Shabi Rexhallari thekson:- me datë 25.05.2021 është marr vendim për transfere të mjeteve. Vendimi është dërguar në Ministri të Financave e cila ka kërkuar që të ndryshohet nenë tre e vendimit te emërtimi i projektit, kërkohet që të ndryshohen dhe të jenë saktë projektet, ndërsa shumat nuk ndryshohen. Në material i keni të specifikuara në detale.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë diskutim sa i përket materialit shtesë, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës

1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Habib Thaçi.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës.
8. Propozim vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01.Nr.2010/2021 për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
9. Të ndryshme.

1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Habib Thaçi.

Kryesuesi thekson:- ftoj z.Habib Thaçi që ta jep betimin.

Habib Thaçi thekson:- Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për , 1 abstenim (z. Habib Thaçi).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

3. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- deri më tanë janë kryer 1714 teste serologjike, ndërsa teste rapide gjithsejtë i kemi kryer 188 teste . Aktualisht i kemi 11 raste pozitive. Dy raste i kemi pasur të hospitalizuar , ndërsa pjesa tjeter është në vet izolim shtëpiakë. Është duke vazhduar vaksinimi kovid 19 dhe deri më sot që jam duke raportuar janë vaksinuar 247 persona, prioritet ka qenë personeli mjekësorë dhe pastaj sipas kategorive të personave të moshuar.

Sabrije Krasniçi thekson:- a ka pasur kundër efekt vaksinimi për shkak se kam dëgjuar që disa pacientë pas marrjes së vaksinës kanë pasur komplikime shëndetësore.

Florim Shkreta thekson:- është formuar një shtab emergjentë për çështje të kovidit dhe a keni mbështetje si drejtoreshë prej këtij shtabi. Personat që po dalin pozitiv prej IKSHPK-së nuk po izolohen dhe po bredhin rrugëve. Kërkoj informacion për shtabin emergjentë se çfarë pune ka bërë deri më sot.

Sead Vila thekson:- si shkon përzgjedhje për këto kategori që po vaksinohen.

Habib Thaçi thekson:- sa përqind e personelit shëndetësorë janë vaksinuar dhe a ka ende prej personelit shëndetësorë që nuk i kanë marr vaksinat. Personat e moshuar kam vërejt që ka hezitim në marrjen e vaksinës.

Medina Imishti thekson:- sa i përket efektit të vaksinës në informata që i kam prej drejtorit deri më tanë nuk kemi pasur ndonjë rast që ka pasur alergji, ndërsa ethe dhe temperaturë kanë mundur me pasur por mjekët ju kanë sugjeruar për terapinë që me përdor. Pjesë e shtabit janë të përfshirë të gjithë sektorët të cilët kanë të bëjnë me parandalimin e situatës kovid 19. Për çdo pacientë të cilin e kemi pozitivë përgjegjësia e inspektoratit eshtë që të lëshon vendim dhe normalisht ta kontrollojë. Kopja e vendimit i dërgohet policisë, QKMF-së, IKSHPK-së. Ne e kemi vetëm një inspektore sanitare dhe nuk mundet vazhdimisht me dal në teren dhe për atë bashkëpunimi me policinë eshtë i domosdoshëm. Ligji për parandalimin e sëmundjeve ngjitetë i ka paraparë gjobat jashtëzakonisht të mëdha dhe personalisht përmes mu nuk ka qenë e moralshme që nëse një familje i kemi dhënë ndihma me një pako në vlerë prej 50 € apo 100 € dhe i njëjtë eshtë parë në mos respektim të ndonjë mase na me i dhënë gjobë 500 € deri në 2000 €. Në çdo mbledhje që kemi pasur me shtabin kemi potencuar që nëse nuk eshtë ngritur vetëdija që një vit normalisht gjobat do të jenë të pashmangshme sa do që janë të larta. Sa i përket vaksinimit listën e pacientëve të moshuar dhe me sëmundje kronike e kemi përcjellë në Ministri të Shëndetësisë që ajo listë ka ndikuar që na me i pasur ato doza të vaksinave. Sipas informatave që kam janë katër raste të personelit shëndetësorë që e kanë refuzuar vaksinimin dhe pjesa tjetër e personave të moshuar.

Sabedin Hasallari thekson:- sa eshtë afati vaksinave të cilët kanë mbetur ende pa u shpenzuar. Trendi i qytetarëve me kovid a eshtë në rënien apo në rritje në bazë të analizave të cilat i keni bërë në krahasim me muajin e kaluar .

Florim Shkreta thekson:- pyetje i parashtrova drejtoreshë se me që eshtë e gjinisë së kundër nuk eshtë e mundur rregullisht me i parë personat sidomos ata të cilët janë me kovid se si bredhin dhe për atë kërkova të informohem se a ka mbështetje prej shtabit emergjentë. Gjërat më elementare nuk i shohë në rregull sa i përket kësaj çështje përmes shkak se personat të cilët thirren në emër të anti kovidit janë po këto persona të cilët e shpërndajnë virusin se nuk mundem me kuptuar si eshtë e mundur që katër infermieri me hipë në ambulancë me një karrig përrpara, këtë nuk mundem me kuptuar sepse në gjendje normale makina eshtë e paraparë përmes dy persona. Sa i përket çështjes së ndihmave eshtë ora policore dhe nuk e kuptojë se me çfarë logjike ndihmat ndahen në orë policore sepse si qytetarë mund të më shkon mendja që ka gjasa që minden me u keqpërdorë . Nuk eshtë transparencë përmes shkak se nuk e shohë asnjë person i cili punon në entitetin social i cili mund ta ketë listën me veti dhe e dinë kujt ja dërgon ato ndihma

Medina Imishti thekson:- sa i përket pyetjes së z. Sabedin Hasallari vaksinat i kemi obligim përmes me i shpenzuar dhe me ju dhënë pacientëve deri në fund të muajit maj dhe nëse nuk shpenzohen të gjitha, kthehen në Ministri të Shëndetësisë. Gjatë kësaj javë të gjitha testimet që i kemi bërë mbi tetëdhjetë përqind kanë dal raste negative dhe kështu që edhe këtu po shihet që ka rënien të rasteve.

Rufki Suma thekson:- sa i përket kovidit drejtoresha i përmendi të gjitha, mirëpo përmes Florimin gjithmonë eshtë hajni, gjithmonë eshtë keqpërdorim e që eshtë bindje e tij që na nuk mundemi me ja ndaluar. Ne i falënderojmë shoqatat humanitare të cilat po na sjellin ndihma në këtë kohë krize. Komuna kohët e fundit mbanë përgjegjësi përmes shoqatës humanitare "Jetimat e Ballkanit" që i kanë përcjell drejtë përmes drejtës komunë 100 pako ushqimore dhe higjenike. Nuk kemi ndonjë person të cilin jemi duke e paguar përmes shpërndarë ndihma por duhet të falënderohen vullnetarët të cilët paraqiten në baza vullnetare sepse lehtë eshtë me folur prej karriges së këshilltarit por nuk eshtë lehtë me dal dikush që përveç punës së vetë të përditshme që e ka me kryer edhe punë të tjera edhe gjatë ditës. Ndihmat janë ndarë Jashtë orës policore por mund ti ketë nxënë ndonjë herë ndoshta ora policore.

Florim Shkreta thekson:- po më vjen keçë prej kryetarit të komunës se shpifjet nuk ndodhin prej kësaj ulëse këtu por prej ulëses tënde atje dhe unë në fillim nuk e ceka që hajni por si qytetarë mund të më shkon mendja që mundet me pasur hajni. Sa i përket asaj që po i falënderon vullnetarët eshtë mirë me i falënderuar por ata vullnetarë që në fund të muajit i dalin paret dhe i hyjnë në kuletë nuk janë najë far lloji i vullnetarit përmes shkak se paguhën përmes punës që e bëjnë dhe përmes mëditje që i marrin koton. Falënderoj do vullnetarë të tjerë siç janë administratorët e fshatrave që përmes katër apo gjashtë vite ua keni keqpërdorur mjetet financiare dhe nuk i keni paguar.

Rufki Suma thekson:- për kryetarët e këshillave të fshatrave rregullorja nuk e ka përcaktuar fare që duhet të kompensohen, keni punuar vullnetarisht edhe pse ty bash asgjë nuk ke punuar të tjerët po dhe unë mendoj që është e kotë të merrem me këtë.

Mefail Suma thekson:- nga QKMF jam ftuar në telefon për me marr vaksinën anti kovidë dhe e kam marr por ju bëjë thirrje qytetarëve që mos të hezitojnë dhe të mos frigohen. Është e vërtetë që ka pak temperaturë , ethe por kjo ndodhë varësisht te ndërtimi i trupit të njeriut.

Teuta Shkreta thekson:- është bërë një punë e madhe dhe e koordinuar në bazë të personave adekuatë. Është një gjë e mirë që ka ndodhë për çështje të vaksinave dhe është mirë që mos të hezitojnë qytetarët.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje, sqarim apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- tabela numër katër pika katër pikë dy te performanca e shpenzimeve kodi 1342 shpenzimet e përfaqësimit të avokaturës. Kodi 13501 mobile më pakë se njëmijë euro. Shpenzime për kompjuterë dhe pse këta kompjuterë janë blerë kur ne dimë që njëzet kompjuter janë dhënë donacion nga kolegu i kryetarit të komunës Sedat Peker. Pse ka pasur nevojë me i blerë këto kompjuter kur kemi mundur me i përdorë kompjuterët të cilët janë dhënë donacion. Kërkoj sqarim për mobilet të cilat janë blerë për shkak se nuk është dhënë ndonjë sqarim i veçantë. Kodi 13620 ushqim dhe pije jo dreka zyrtare 3,748.00 € kërkoj sqarim si janë shpenzuar. Mirëmbajtja rrugëve lokale (mirëmbajtja dimërore) në shumë prej 9,049.80 € që përveç ditës së zgjedhjeve që e kanë pastruar borën mirëmbajtje të tjera nuk e di që ka pasur . Për shpenzimet e varrimit , të telefonisë mobile a bëhet fjalë për pagesa të më hershme apo për shpenzime të TM 1 për vitin 2021. Unë nuk po e kuptojë edhe gjuhën e kryetarit të komunës por si shef i grupit parlamentarë të PDK-së si kryetarë është mirë me pasur kujdes se ty je kryetarë komunë dhe ne secili mundohemi me respektuar pozicionin pavarësisht kush është pak rëndësi ka dhe me përdorë gjuhën ndaj një anëtarë të kuvendit të komunës së skam qa merrna me ta po më doket që nuk është e hijshme se nuk takon me potencuar dhe mllefin mos e paraqit në institucion.

Habib Thaçi thekson:- furnizime mjekësore në tre mujorin e parë të viti të kaluar ka pasur shpenzime 2,968.47 € , ndërsa në tre mujorin e parë të viti 2021 nuk ka pasur. Pse nuk i është dhënë prioritet furnizimit me medikamente në këtë tre mujorë. Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i ujësjellësit në shumë prej 40 000 €. A ka plan konkret se si do të bëhet shtimi i kapaciteteve të ujësjellësit. Pajisja e kabineteve me mjete mësimore dhe mjete laboratorike, blerja e pajisjeve për salla sportive. Unë mendojë që secila shkollë është e pajisur me mjete mësimore për kabinetet dhe janë duke ju tepruar por duhet të përdoren por do të ishte më mirë që këto mjete me i bartur te pajisjet sportive për shkolla. Propozoj që shkollat të pajisen me nga një smart bord për shkak se pajisje për kabinete kanë mjaftueshëm shkollat.

Nora Xhoni thekson:- këtë raport nëse e krahasojmë me tre mujorin vitit të kaluar shihet që ju është dhënë prioritet projekteve që do të thotë që 90 % ka ngritje . E përshëndes raportin dhe mendoj se është në rregull dhe urojmë të vazhdoj tutje.

Sead Vila thekson:- shqetësim kam si këshilltarë te pika e mëditjeve dhe shtesa a është shabllonë i ministrisë tabelari që gjithmonë shkon paralel apo ka mundësi me u ndarë edhe dy nënkategori në mënyrë që me u ditë mjetet të cilat kanë shkuar në paga dhe shtesa . Nuk është që po dyshojë por nuk është praktikë e gjitha institucioneve që me i përfillë punëtorët për punët të cilat i bëjnë në sektorë të ndryshëm, në kategori të ndryshme për me i kompensuar për punën shtesë të cilën e bëjnë.

Shabi Rexhallari thekson:- për shpenzimet e avokaturës ka të bëjë me pagesat të cilat eksperti e ka bërë ekspertizën për pronat të cilët janë në emër të komunës. Ministria e Infrastrukturës e ka llogaritur një euro për metër katrorë pjesën ku është bërë autostrada dhe komuna nuk është pajtuar me atë çmim. Mobilet janë paguar për shëndetësinë për te QKMF-ja. Vitin e kaluar e kemi kryer këtë pagesë por mjetet financiare janë kthyer pa fajin tonë por me fajin e Qeverisë pra Ministrisë së Financave dhe patjetër jemi detyruar për me i paguar për së dyti. Përpos mobileve vitin e kaluar i kemi paguar edhe kompjuterët por e njëjtë ka ndodhë sikur me mobilet që deri me datë njëzet e katër dhjetorë gjithçka ka qenë në rregull por njoftimi ka ardhur me datë pesë janar që mjetet financiare janë kthyer e që vlera ka qenë 28000 € e cila nuk ka ndodh vetëm në komunën tonë por ka ndodhur në të gjitha komunat. Pagesat për ushqim dhe pije për pos që furnizohemi nga bifeja me pije tash furnizohet edhe çerdhja me ushqim për fëmijët. Te mirëmbajtja e rrugëve nuk ka qenë vetëm mirëmbajtja e rrugëve dimërore por është edhe mirëmbajtja e rrugëve edhe për sezonat tjera jo vetëm dimërore. Shpenzimet e varrimit deri në vitin e kaluar na është sugjeruar me u kryer pagesat nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa auditorët kanë sugjeruar që shpenzimet e varrimit me u paguar nga kategoria subvencione dhe transfere. Në këtë tre mujorë bashkësia islame nuk i ka dërguar dokumentet por i ka dërguar në muajin prill që do tu paraqesin në tre mujorin e dytë të shpenzimeve. Vitin e kaluar kemi bërë furnizime mjekësore në shëndetësi dhe për momentin nevojat janë të mjaftueshme dhe për këtë arsy s'kemi pasur shpenzim mjekësorë gjatë këtij tre mujori. Gjithçka që paguhet në kuadër të kategorisë paga dhe shtesa hynë me një kolonë dhe nuk mund të ndahet.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket shumës për shtimin e kapaciteteve të ujit kemi bërë marrëveshje me CDI-në dhe mendojmë që në këtë vit duhet të fillojnë punimet edhe pse tenderi dy apo tri herë ka dështuar.

Menduh Vlashi thekson:- është punë e mirë kur teprojnë mjetet nëpër shkolla por këto dy investime janë planifikuar të bëhen për shkollën mesme për shkak se nuk janë të pajisura kabinetet me mjete të nevojshme. Pajisje sportive kanë nevojë për shkak se janë ndërtuar sallat sportive.

Sabedin Hasallari thekson:- raporti i të hyrave vetanake për vitin 2021, të hyrat nga deklarimet publike janë paraparë 6000 € , ndërsa janë realizuar 1000 € dhe nuk e keni paraqitur përqindjen. Drejtoria e zhvillimit ekonomik është në minus sa i përket mbledhjes së të hyrave vetanake.

Shabi Rexhallari thekson:- te drejtoria e zhvillimit plani ka qenë 77500 € ndërsa realizimi është 4219 €. Në këtë vit nuk kanë mundur ë tre mujorin e parë me i shpërndarë aktvendimet dhe besoj që tash do të fillojnë edhe pagesat.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për , 4 kundër (tre nga grupi parlamentarë i PDK-së dhe një nga grupi parlamentarë Nisma).

5. Informatë për ndarjen e bursave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- në materialin e informatës për bursa janë paraqitur të gjitha të dhënat në detale dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Teuta Shkreta thekson:- kërkoj informacione për studenten Fatbaradha Tefik Sadriu. Duhet të ndryshohet rregullorja për shkak se nëse një studentë punon duhet të stimulohet dhe të përkrahet nga komuna sepse ai nuk besoj që e ka ndonjë punë në institucion shtetërore por detyrohet të punon privat për me i mbuluar shpenzimet e familjes.

Kryesuesi thekson:- nëse vlerësohet se rregullorja ka nevojë me u ndryshuar mund ta ndryshojmë por mendojmë që rregullorja është e kompletuar. Edhe në KPF mendimi i të gjithë anëtarëve ishte që një studentë që punon nuk ka nevojë për me marr bursë. Bursat janë shpërndarë në bazë të rregullores dhe gati se të gjithë kanë marr bursë.

Menduh Vlashi thekson:- studentët e viti të dytë të gjithë e kanë marr me përjashtim të studentes Natyra Kalisi dhe janë shtuar edhe katër student të vitit të parë.

Teuta Shkreta thekson:- unë e paraqita mendimin tim dhe drejtori ne ta shënon si propozim dhe në momentin kur të procedohet për ndryshim ne të hiqet kjo pikë. Arsyet i paraqita siç theksova më lartë.

Mefail Suma thekson:- me një familje që janë dy studentë ju është zbritur shuma por mendojë që është shkelje e të drejtave të një individi studentorë. Kur të vjen koha e punësimit a mos me u punësuar se janë dy persona të një familjes. Rastet që prej një familje dy student të mirë dhe me notë mesatare të lartë janë të rralla por përkundrazi këto duhet të shpërblehen për shkak se bursa ipet për studentë e jo për familje.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendojë që jemi duke diskutuar për ndarje të bursave e jo për plotësim ndryshim të rregullores. Në momentin që propozojmë me ndryshuar rregullores secili ne ti paraqet propozimet e veta.

Habib Thaçi thekson:- unë mendoj që z. Teuta Shkreta ka drejtë për propozimet që i dha pasi që vetëfinancimi nuk do të thotë që studenti merr një pagë të rregullt dhe në këtë mënyrë kemi me i bërë studentët tonë pasiv për shkak se mund të potencojë pse me punuar kur unë marr bursë. Puna nuk është e vazhdueshme sepse mund të punon një muaj, dy apo tre dhe dhjetë muaj tjerë çka bënë ai. Kush e formon komisionin për shqyrtimin e kërkësave për përzgjedhjen e bursistëve. Për me qenë më transparentë duhet të përfshihen edhe anëtarë tjerë të komisionit.

Menduh Vlashi thekson:- kryesisht është diskutuar këtu për rregulloren, mirëpo kjo është raport mbi ndarjen e bursave nëse jeni në dakord mund ta merrni iniciativën për me ndryshuar rregulloren për shkak se në kuwend është miratuar. Komisioni formohet prej drejtorisë komunale i cili e bënë rangimin në bazë të pikëve dhe ju ka përbajtur rregullores që nuk mundet me ikë rregullores. Transparencë është bërë për shkak se të gjithë studentët i kam ftuar në sall dhe ua kemi shpjeguar në detale.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

6. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Mefail Suma thekson:- kompania ka suksese vazhdimisht dhe është mirë me ju shtuar edhe veprimitari tjera mos me bërë vetëm pastrimin.

Sead Vila thekson:- te mallrat dhe shërbimet pse është një diferencë shumë e madhe e shpenzimeve të karburanteve.

Habib Thaçi thekson:- pagat dhe mëditjet e bordit për vitin 2020 në shumë 607.89 €, ndërsa për vitin 2021 në shumë 840 €. A kanë edhe pagë shtesë apo janë të varur vetëm prej mëditjeve.

Sabedin Hasallari thekson:- sa i përket shpenzimeve për karburante është rritur volumi i punës për shkak se është shtuar stafi i punëtorëve në kompani. Vërejtje kam te shpenzimet e deponisë për shkak se volumi i punës është rritur dhe për vitin 2020 për deponi keni paguar më shumë ndërsa në vitin 2021 keni paguar më pakë. Totali i të hyrave dhe shpenzimeve në fund është shënuar fitimi (humbja) neto është një lloj paqartësi dhe kërkojë sqarim.

Kujtim Dernjani thekson:- fitimi humbja neto është termë që e përdorin kontabilistat po në këtë rast është fitimi. Shpenzimet e deponisë janë më vogla që i bien më pak mbeturina që për neve është mirë. Pagesat e mëditjeve të bordi të është rritur për shkak ngritjes së mëditjeve që janë bërë për anëtarët e bordit. Shpenzimet e karburanteve janë rritur për shkak se në këtë vit e kemi marr një traktor që na i ka dhuruar Gizi Gjerman.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- z.Sokol Loku ka parashtruar kërkesë për ndërrim destinim të pronës dhe e kemi përcjell në kuvend për shkak se pronë e klasit të pestë dhe gjashtë e cila duhet të miratohet në kuvendin e komunës. Komisioni ka dal në vend ngjarje dhe e ka përgatitur raportin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E SOKOL LOKU PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

8. Propozim vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01/Nr.2010/2021 për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- Ministria e Financave ka kërkuar që të bëhen ndryshimet te neni tre i vendimit pikërisht et tabela e emërtimit të projekteve për shkak të disa ndryshimeve të cilat kanë ndodhur në vitin e kaluar. Më herët e kemi pasur shtrimi me kupza betoni në zonën rurale dhe urbane , ndërsa tash kërkohen të përcaktohen se cilat rrugë kanë me u shtruar në zonë urbane apo rurale. Janë bërë përmirësimet dhe janë përfshirë edhe rrugët edhe kanalizimet. Te mjetet financiare nuk ka ndryshim.

Mefail Suma thekson:- opozita ka kërkuar shpesh për me bërë vlerën për caktimin e secilës rrugë dhe asnjë herë nuk është marr parasysh. Dhe tash po doke se çajo ka rënë që është kërkuar që të përcaktohen se cilat rrugë. Unë kërkojë që për secilën rrugë të i ipet vlera saktë se ku do të shtrohet sepse atëherë e keni dhënë vetëm objektivin që i keni përfshirë shtatë fshatra apo rrugë dhe e keni përcaktuar një shumë. Si këshilltarë kemi kërkuar koston por asnjë herë nuk kemi mundur ta dimë.

Mehmet Ballazhi thekson:- edhe në procesverbal është shënuar kur kam kërkuar specifikimin e projekteve dhe kam kërkuar që së pak me pasur një paralogari për projektin. Janë përcaktuar emrat e rrugëve në Han të Elezit , Paldenicë , Rezhancë dhe në fund është shënuar shuma 30 000 €, mirëpo a ka logjik që me këto mjete krejt këto projekte me u kryer. Çështja e ujit nuk ka hyrë si prioritet. Rregullimi i shtigjeve për këmbësorë nuk e keni paraparë. Keç planifikimi dhe keç projekcionet kanë arritur deri këtu që me i kthyer Ministria e Financave.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për , 4 kundër(tre nga grupei parlamentarë i PDK-së dhe një nga grupei parlamentarë Nisma).

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01/Nr.2010/2021 PËR TRANSFER TË MJETEVE NGA KATEGORIA EKONOMIKE REZERVA NË SHPENZIME KAPITALE

3. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- kyçja në magjistrale prej rrugës së fshatit Dimcë mirë që është bërë që mos me u parkuar veturat por kërkoj që nga ana e majtë që janë disa punëtori po kemi pengesa për me u këqyr në magjistrale sepse nuk po shihet asgjë. Është mirë të vendoset një shenjë për ndalim parkimi. E përgëzoj komunë që e ka bërë vjetarin por ka shumë gabime drejtshkrimore. Është përmendur shumë kuvendi por në secilën faqe është i fotografuar nga shpina dhe nuk është transparencë kjo. Kam kërkuar një herë prej zyrtarit të informimit që secilin asamblistë me e ftuar me dhënë një intervistë se çka mendon për komunën e Hanit të Elezit. Opozita me një vendim këtu ishte kundër dhe asnjë herë nuk përmendet por ne jemi kuvend nuk do të thotë që pajtohem i një çdo gjë. Nuk është e thanur me shënuar vetëm rendin e ditës por zyrtari për informim ta jep mendim e jo ta merr procesverbalit por ta jep edhe vet që ka qenë prezent në mbledhje që së paku një herë të përmendet emri i secilit asamblistë. Unë nuk e kisha quajtur vjetarë por informatorë vjetarë sepse duhet të ju afroheni brumit të informimit se jeni lagë me transparencë. Po na i mohoni drejtat tona nuk po na i plasoni në informim.

Sead Vila thekson:-jam anëtarë i shoqatës së pedagoge të sportit dhe përveç takimit të zgjedhjes së kuvendit dhe pjesë nuk kam marr por aty është një rregullore dhe janë të specifikuara disa detyra. Shkollat tona marrin pjesë nëpër gara komunale, regionale dhe republikane . Po më brengosë se neve po na mungon shpirti ideal për me punuar me ata nxënës sepse nëse i marr ndonjë fëmije mjete financiare po më doket se është konflikt interesit për shkak se unë jam i sportit dhe kërkoj që me më paguar për me ushtruar. Unë jam mësimdhënës dhe përveç orarit të rregullt duhet me gjejë kohë edhe jashtë orarit me punuar me ata fëmijë që kanë shkathësi dhe talent. Kërkoj që mos me u anashkaluar shoqata e pedagoge dhe çdo aktivitet i sportit të jetë në suaza të kësaj shoqate por duhet të gjinden forma të organizimit. Kjo është shqetësim i shumë prindërve të cilët kanë kërkuar që unë këtë çështje me paraqitur në kuvendin e komunës .

Habib Thaçi thekson:-rruga nga qendra deri te shkolla fillore së paku një herë në javë me u pastruar për shkak se kamionët e Sharrcem-it po e ndotin atë rrugë. Duhet kompania “Sharrcem” ta cakton një person përgjegjës për hyrjen dhe daljen e kamionëve për shkak se reziku është shumë i madh .

Florim Shkreta thekson:- unë kisha kërkuar që të paktën me mbështetur biznesin që e ushtron veprimtarinë të pjesa e parkingut të kamionëve të kompanisë “Sharrcem”. Komuna sa ua shtron disa oborre do militantëve me kupëza betoni është mirë me shtruar atë parking që mos me u bërë pluhur. Shqetësim kam prej banorëve për kolonën e cila po bëhet te kufiri a diskutohet në mbledhje të KKSBB-së për këtë çështje sepse ne dimë që për momentin komuna nuk mund ta ndryshon atë pjesë por në momentin që bllokohet të jetë në dioni të paktën policia në mbajtje të rendit. Është për lëvdatë heqja e pengesave në trotuar te QKMF-ja.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a kanë pasur ndonjë takim me shoqatën “Ilamik Relief” për çështjen e punëtorëve të cilët janë pa kontrata në shëndetësi. Të bëhet pastrimi te ura e Seçishtës për shkak se janë hedhur disa pllaka të cilat përbajnjë azbestë.


Rufki Suma thekson:- aty ku janë të domosdoshme i kem vendosur shenjat e parkingut dhe ka raste që policia po kërkon me i vendosë shenjat dhe komuna po i vendosë por ata nuk po ndërmarrin asgjë. Te lokalit që është në magjistrale nuk mundemi mi bllokuar për shkak se është para lokalit dhe është e vërtet që pengojnë por polica mund të ndërmerr masa nëse donë po ne nuk mundemi mi urdhëruar. Vjetari nuk mund të i përcakton dhe shënon procesverbalet dhe për ata që duan me i lexuar se kush është për dhe kundër janë procesverbalet të cilat janë të publikuara në ven faqe të komunës dhe munde me i lexuar kur të duan. Në vjetar i kemi të skanuar edhe vendimet që është e vetmja komunë në Kosovë që i publikon në vjetarë. Sa i përket fotove mund të ketë gabime dhe shpesh i kam sugjeruar që mos me i përsëritur dy apo tri herë. Vjetari është i mirë për shkak se pasqyrojë punën njëvjeçare të komunës. Aktivitet sportive çdo herë i kemi përkrahur mbështetur brenda mundësive buxhetore që i kemi pasur. Çdo herë në sezonë verore kemi kërkuar që të bëhet pastrimi i rrugëve nga kompania “Sharrcem” dhe del e pastron por nuk është e mjafueshme. Sa i përket parkingut të kamionëve të cilët parkohen është parking privat dhe vërejtje i kemi bërë kompanisë “Sharrcem” për me i larguar nga ajo pjesë për shkak se po e bllokoni rrugën dhe në mbledhje të KKSBB-së e kemi diskutuar dhe kompania shumë herë ka paguar edhe punëtorë për me u kujdesur në hyrje dhe dalje të kamionëve në mënyrë që mos me pasur probleme. Në çdo mbledhje të KKSBB-së është biseduar çështja për te kufiri dhe kemi kërkuar që për deri sa nuk është bërë zgjerimi i rrugës kur ka bllokadë policia me dal dhe me drejtuar komunikacionin, por është pak problem kanë mungesë të stafit. Kemi biseduar me shoqatën “Islamik Relief” por kanë potencuar që mundësitë janë në muajin maj për shkak se edhe kontrata e cila ka skaduar të cilën e kemi nënshkruar është nënshkruar në muajin maj.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendorit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:06.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



**Kryesuesi i Kuvendit
MSC. Qamush Brava**

